

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXIV, nr. 7940  
E martë, 26 nëntor 2024  
Çmimi 0.50

## Kosova po ndërton stacione të reja policore në veri



Na ndiqni edhe në:  
[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR** **ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

# KRASNIQI, KRYEPARLAMENTARIT TË MAQEDONISË: ARRESTIMI I VETERANËVE TË UÇK-SË CENON RAPORTET NDËRSHTETËRORE



Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), lideri opozitar Memli Krasniqi, është takuar të hënën me kryetarin e Kuvendit të Maqedonisë së Veriut, Afrim Gashi, i cili po qëndron për vizitë zyrtare në Prishtinë. Gjatë këtij takimi,

Krasniqi ka shprehur shqetësimin lidhur me arrestimin e veteranëve të UÇK-së në Maqedoninë e Veriut. "Veprim ky i papranueshëm, që cenon raportet tona ndërshtetërore, me ç'rast kërkova që faktori shqiptar atje të

angazhohet fuqishëm për ndaljen e këtyre përndjekjeve", ka thënë Krasniqi pas takimit. Kryeparlamentari i Maqedonisë së Veriut ka takuar edhe kryeparlamentarin Glauk Konjufca dhe kryeministrin Albin Kurti

## OPINION

### PËRMBYSJA E MADHE APO LOJA E MADHE

Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA



## AKTUALE



### NË KOSOVË NIS FUSHATA GLOBALE "16 DITËT E AKTIVIZMIT KUNDËR DHUNËS ME BAZË GJINORE"

### TËRHIQET PECI, ANULON GRANTET PËR KËSHILLTARIN E VET DHE VËLLANË E FITORE PACOLLIT

## EKONOMI



### BËHET INAUGURIMI I FILLIMIT TË PUNIMEVE PËR NDËRTIMIN E PARKUT INDUSTRIAL NË DRENAS

### HOTI: ME MIRATIMIN E BUXHETIT JANË BËRË DY SHKELJE, PRESIDENTJA DO TË DUHEJ T'IA KTHENTE KUVENDIT KËTË LIGJ

## SPORT



### DRITA ME PËRMBYSJE FITON DERBIN NDAJ LLAPIT

### SBASHK-u NIS VEPRIMET SINDIKALE, PROTESTON MË 4 DHJETOR



### FAHRIJE HOTI KËRKON NGA PECI TË KËRKOJË FALJE PUBLIKE: NUK LEJOJ TË NJOLLOSET EMRI IM DHE I GRAVE TË KRUSHËS



**RENOVA**  
Maqedoni  
Xhepçisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
PUTZ  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)  
Mobi: +377 44 501 289

**PRINCESHA** GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
030 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBANKIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë.  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

# Ambasadori izraelit: Marrëveshja për armëpushim me Hezbollahun mund të arrihet brenda ditësh

**BJERU, 25 NËNTOR** - Ambasadori izraelit në Uashington tha se një marrëveshje armëpushimi për t'u dhënë fund luftimeve në mes të Izraelit dhe Hezbollahut - grupit militant dhe partisë politike që kontrollon shumicën e jugut të Libanit - mund të arrihet "brenda ditësh".

Ambasadori Mike Herzog tha për radion e ushtrisë izraelite më 25 nëntor se ka "pika që duhen finalizuar", por ai tha se "ne jemi afër një marrëveshjeje" dhe se ajo "mund të arrihet brenda ditësh".

Në mesin e çështjeve që mbeten të pazgjidhura është edhe një kërkesë e Izraelit që

thotë se shteti rezervon të drejtën të veprojë nëse Hezbollahu shkel obligimet nga marrëveshja e re. Marrëveshja synon të largojë Hezbollahun dhe trupat izraelite nga jugu i Libanit. Hezbollahu është shpallur organizatë terroriste nga Shtetet e Bashkuara, ndërsa Bashkimi Evropian e ka vendosur në listën e zezë krahun e tij të armatosur, por jo edhe partinë e tij politike.

Hezbollahu nuk i është përmbajtur një rezolute të Kombeve të Bashkuara që i dha fund luftës së vitit 2006. Në këtë rezolutë palët kishin bërë kërkesa të ngjashme. Libani, po ashtu, e ka



akuzuar Izraelin se e ka shkelur këtë rezolutë. Ende është e paqartë nëse Libani do ta pranojë

kërkesën e Izraelit. Optimizmi rreth arritjes së një marrëveshjeje vjen pasi i dërguari i ShBA-së mbajti

bisedime me palët javën e kaluar, me synim që të arrihet një marrëveshje.

Hezbollahu nisi sulmet në kufi kundër Izraelit më 8 tetor 2023, një ditë pasi Hamasi - grupi palestinez i shpallur organizatë terroriste nga ShBA-ja dhe BE-ja - sulmoi jugun e Izraelit që nxit luftën në Gazë.

Luftimet në mes të Hezbollahut dhe Izraelit u përshkallëzuan shtatorin e këtij viti, me Izraelin që nisi sulme masive ajrore në Liban dhe më pas nisi një ofensivë tokësore në jug të Libanit.

Hezbollahu ka gjuajtur mijëra raketa në qytetet izraelite, përfshirë rreth 250 që i lëshoi më 24 nëntor.

## Rrahje mes deputetëve në Kuvendin e Serbisë



**BEOGRAD, 25 NËNTOR** - Në seancën e Kuvendit të Serbisë më 25 nëntor, pati shtyrje dhe përleshje mes përfaqësuesve të pushtetit dhe atyre të opozitës. Përveç deputetëve, në incident u përfshinë edhe ministri të Qeverisë, ndërsa sigurimi i Kuvendit i ndante ata.

Deputetët opozitarë më herët kishin kërkuar që Kuvendi, në të cilin po diskutohet për buxhetin, të votojë për mosbesimin e Qeverisë pas aksidentit në Novi Sad, ku humbën jetën 15 persona. Megjithatë, pushteti e refuzoi atë propozim.

Gjatë transmetimit të seancës parlamentare nuk u pa qartë se si filloi incidenti, ndërsa zëri ishte i fikor, prandaj nuk mund të dëgjohet se çfarë po i thoshin deputetët njëri-tjetrit. U pa që deputetët e pushtetit dhe të opozitës po ndaheshin nga sigurimi i Kuvendit, ndërkohë që goditeshin, tërhiqeshin, shtyheshin, lageshin me ujë dhe qëllonin njëri-tjetrin.

Kryetarja e Kuvendit, Ana Bërnabiq, pas incidenteve e akuzoi opozitën për "përpjekje për uzurpim të dhunshëm të pushtetit". Ajo akuzoi deputetët opozitarë se, pas

ndërprerjes së seancës, "shkulën mikrofonat" dhe "thyen ekranin" për të "penguar" vazhdimin e saj. "Kështu duket liria e fjalës sipas interpretimit të tyre", ka deklaruar Bërnabiq në një konferencë për media në hollin e Kuvendit, ndërsa deputetët opozitarë frynin bilbila dhe vuvuzela.

Bërnabiq u shfaq para gazetarëve e shoqëruar nga deputetët e shumicës qeveritare, ndërsa rreth saj dhe medieve qëndronte sigurimi i Kuvendit. Pas sigurimit ndodheshin deputetët e opozitës.

## Ciolacu prin në zgjedhjet presidenciale të Rumanisë, sipas sondazheve

**BUKURESHT, 25 NËNTOR** - Kandidati i Partisë Social-Demokrate për president të Rumanisë, Marcel Ciolacu, po prin me 25 për qind të votave në rundin e parë të zgjedhjeve të mbajtura të dielën, sipas sondazheve publike. Megjithatë, Ciolacu, aktualisht kryeministër i shtetit, duket se do të vazhdojë garën në rundin e dytë, dhe ka mundësi që kundërkandidate të ketë Elena Lasconin, nga Unioni për Ruajtjen e Rumanisë, parti e qendrës së djathtë.

Pas mbylljes së vendotimeve, kompanitë e sondazheve e kanë renditur Ciolacun të parin me 25 për qind të votave, ndërsa Lasconin në vendin e dytë me 18 për qind.

Kandidati i pavarur Caiin Georgescu dhe George Simion, lider i së djathtës ekstreme,

duket se kanë fituar 14-16 për qind të votave.

Në garën për president të shtetit kanë qenë 13 kandidatë. Nëse asnjëri kandidat nuk fiton mbi 50 për qind të votave, rundi i dytë i zgjedhjeve do të mbahet më 8 dhjetor, mes dy kandidatëve të parë.

Rumania do t'i mbajë edhe zgjedhjet parlamentare më 8 dhjetor.

Ciolacu ka qenë vazhdimisht në krye të garës, edhe në sondazhet paraprake, për të zëvendësuar presidentin aktual të qendrës së djathtë, Klaus Iohannis, i cili përfundon mandatin e dytë dhe një dekadë në pushtet.

Zyrtarët zgjedhorë kanë thënë se dalja në zgjedhje ka qenë 52.4 për qind, që do të thotë se rreth 9 milionë shtetas rumunë kanë votuar.



Radhë të gjata janë raportuar nëpër qendrat e votimit në kryeqytetin rumun, Bukuresht, pak para mbylljes së vendotimeve.

Lasconi ka qenë kandidatja e vetme për pozitën e presidentit që ka dalë kundër idesë që Ukraina t'i japë tokë Rusisë kur të diskutohet për paqe, me

arsyetimin se një hap i tillë vetëm do të fuqizojë presidentin rus, Vladimir Putin. "Nëse Ukraina dorëzon territor, Putin nuk do të ndalet", ka thënë ajo. Ne duhet t'i ndihmojmë Ukrainës që të fitojë këtë luftë". Ciolacu njihet si pro-evropian. "Ne do të mbështesim thellimin e integritit evropian për të mirën e njerëzve dhe do të kemi rol më aktiv në procesin e vendimmarrjes në nivel evropian", ka thënë ai.

Rumania është aleate e rëndësishme për Ukrainën fqinje, pasi përveç ofrimit të ndihmës ushtarake, ajo ka luajtur rol kyç në transportimin e grurit ukrainas në tregjet globale.

Meritat më të mëdha për qasjen kaq pro-ukrainase të Bukureshtit i shkojnë presidentit aktual Iohannis.

## Fahrije Hoti kërkon nga Peci të kërkojë falje publike: Nuk lejoj të njolloset emri im dhe i grave të Krushës

PRISHTINË, 25 NËNTOR - Fahrije Hoti, udhëheqësja e Kooperativës Bujqësore "Krusha", ka kërkuar nga ministri i Bujqësisë, Faton Peci, të kërkojë falje publike ndaj saj dhe të gjitha grave të Krushës për, siç tha ajo, "njolloset të emrit dhe shpifje ndaj grave të Krushës".

Në një konferencë për medie, Hoti ka thënë se nuk e lejon askënd ta njolloset emrin e saj personal. "Ministri Faton Peci ka një javë që merret me çështjen e zonjës Fahrije Hoti. Nuk lejoj assesi që të më njolloset emri im personal, që unë e kam nisur pa ndihmën e kurrkujt, po ndërkohë na janë bashkëngjitur njerëz të tjerë që na kanë ndihmuar", ka thënë Hoti.

Ajo ka shtuar se nga Ministria e Bujqësisë nuk kanë marrë përkrahje që nga 2015 e deri më sot. "Kemi aplikuar, jemi refuzuar, jo më 2024, por që nga 2015 e deri më sot nuk kemi marrë përkrahje. Arsyeja ka qenë se nuk kemi përmbushur ndoshta kriteret më 2015. Por më 2023 kooperativa kurrë më parë nuk ka qenë më e kompletuar se sot duke marrë parasysh eksportin në BE dhe ShBA", tha Hoti.

Hoti shtoi se nuk do të akuzojë

asnjë subjekt politik dhe se "gjithmonë e kemi pasur derën e hapur për të gjithë dhe vazhdojmë ta kemi".

Hoti ka thënë se asnjëherë nuk ka pasur ndonjë ftesë nga gjykata, siç ka deklaruar Peci. "Ministri Peci e ka përmendur që zonja Fahrije Hoti është paditur në gjykatë, përkundrazi unë nuk kam marrë një ftesë të atillë, asnjëherë nuk më është adresuar një ftesë që unë jam e paditur që nuk i kam kthyer mjetet që m'u kanë ekzekutuar në vitin 2015-2017. Unë nuk e di ku e ka marrë atë dosje dhe kërkoj nga ministri, bashkë me dosjen, të kërkojë falje për këtë njolloset që iu ka adresuar jo vetëm Fahrijes, por të gjitha grave të Krushës. Ministri të ulet dhe të kërkojë falje publike e jo të vazhdojë me shantazhe, video e shkrime në rrejtet sociale", ka deklaruar udhëheqësja e Kooperativës Bujqësore "Krusha".

Ajo ka thënë se presin nga zyra e ministrit takim në mënyrë që të sqarohet arsyeja e refuzimit të grantit. Në fund ajo ka shtuar se në të ardhmen sërish do të aplikojnë për grante dhe "nuk do të dorëzohen në këtë drejtim".



## Në Kosovë nis fushata globale "16 ditët e aktivizmit kundër dhunës me bazë gjinore"

PRISHTINË, 25 NËNTOR - Në Kosovë ka nisur fushata globale "16 ditët e aktivizmit kundër dhunës me bazë gjinore" dhe gjatë kësaj periudhe, institucionet shtetërore dhe organizatat e shoqërisë civile do të organizojnë një sërë aktivitetesh për ndërgjegjësimin kundër dhunës me bazë gjinore.

Ministrja e Drejtësisë e Kosovës, Albulena Haxhiu, më 25 nëntor mori pjesë në orën e parë në shkollën "Ahmet Gashi" në Prishtinë, teksa në të gjitha shkollat në mbarë vendin, ora e parë i është kushtuar ndërgjegjësimin kundër dhunës me bazë gjinore.

Haxhiu u tha nxënësve se dhuna asnjëherë nuk është e pranueshme dhe se ajo nuk duhet të kthehet me dhunë, por ajo duhet raportuar.



"Ministria e Drejtësisë e ka përgjegjësinë që t'i adresojë politikat për adresimin e dhunës në familje dhe dhunës me bazë

gjinore. Deri tani kemi ndërmarrë shumë veprime të cilat kanë për qëllim t'i rehabilitojnë personat të cilët bëjnë veprime të tilla, pra

kryejnë dhunë në familje apo janë të dhunshëm në ambientin familjar, sikurse kemi ndërmarrë shumë veprime që kanë për qëllim që viktimave t'u ofrohen shërbime që u nevojiten", tha Haxhiu.

Ajo tha se shteti ofron ndihmë juridike falas për viktimat e dhunës në familje, teksa ka ndërmarrë hapa për dënime plotësuese për personat që shpallen fajtorë për dhunë në familje dhe dhunë seksuale. Ata, tha Haxhiu, mund të dënohen me dënim plotësues nga Gjykata që do t'u pamundësonte punësimin në institucionet shtetërore. "Dhuna nuk është zgjidhje", u tha ajo nxënësve.

Sipas të dhënave, nga janari i këtij viti deri në muajin nëntor ishin 2 585 viktima të dhunës në familje.

Nga to, 2 055 ishin gra dhe 530 burra.

Shumica e viktimave ishin të moshës 30-40 dhe 20-30.

Nga viti 2010 deri në prill të vitit 2024, në Kosovë janë vrarë 58 gra. Organizatat për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, në disa raste, kanë fajësuar autoritetet për dështim në mbrojtjen e grave të rrezikuara nga dhuna. Në të shumtën e rasteve, autorët të vrasjeve kanë qenë bashkëshortët, pastaj baballarët dhe djemtë.

Fushata globale "16 ditët e aktivizmit kundër dhunës me bazë gjinore" nis në Ditën Ndërkombëtare për Eliminimin e Dhunës Ndaj Grave dhe përfundon më 10 dhjetor, në Ditën e të Drejtave të Njeriut.

## Tërhiqet Peci, anulon grantet për këshilltarin e vet dhe vëllanë e Fitore Pacollit

PRISHTINË, 25 NËNTOR - Ministria e Bujqësisë, e cilat udhëhiqet nga Faton Peci, pas presionit publik, ka pezulluar grantet për vëllanë e deputetes së Lëvizjes Vetëvendosje, Fitore Pacollit dhe të këshilltarit të tij Naim Huruglica.

Sipas dokumenteve, pezullimi për Huruglicën dhe Blerim Pacollin është marrë në të njëjtën ditë, pra më 22

nëntor 2024. "Sipas Programit për Zhvillim Rural, AZHB gjatë vlerësimit dhe procedimit të lëndës është njoftuar nga mediat lidhur me pretendimet e tyre për parregullsi, si rezultat i këtyre pretendimeve ka ndërmarrë hapa ligjor për verifikimin e këtyre pretendimeve", thuhet në vendimin që kanë publikuar mediet.

Lidhja Demokratike e Kosovës

(LDK) ka dorëzuar kallëzim penal ndaj Pecit dhe deputetes së Lëvizjes Vetëvendosje, Fitore Pacollit, të cilët kanë deklaruar se është e papranueshme që familjarët e deputetes të marrin grante në vlerë prej 100 mijë eurosh. Mediet në Kosovë kanë raportuar ditët e fundit rreth favorizimeve familjare dhe shpërthimit të nepotizmit në Ministrinë e Bujqësisë.





## Krasniqi, kryeparlamentarit të Maqedonisë: Arrestimi i veteranëve të UÇK-së cenon raportet ndërshtetërore

Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), lideri opozitar Memli Krasniqi, është takuar të hënën me kryetarin e Kuvendit të Maqedonisë së Veriut, Afrim Gashi, i cili po qëndron për vizitë zyrtare në Prishtinë. Gjatë këtij takimi, Krasniqi ka shprehur shqetësimin lidhur me arrestimin e veteranëve të UÇK-së në Maqedoninë e Veriut. “Veprim ky i papranueshëm, që cenon raportet tona ndërshtetërore, me ç’rast kërkova që faktori shqiptar atje të angazhohet fuqishëm për ndaljen e këtyre përndjekjeve”, ka thënë Krasniqi pas takimit. Kryeparlamentari i Maqedonisë së Veriut ka takuar edhe kryeparlamentarin Glauk Konjufca dhe kryeministrin Albin Kurti

**EPOKA ERE**

Mal QORRAJ

**PRISHTINË, 25 NËNTOR** - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, lideri opozitar Memli Krasniqi, është takuar të hënën me kryetarin e Kuvendit të Maqedonisë së Veriut, Afrim Gashi. Krasniqi gjatë takimit ka shprehur shqetësimin lidhur me arrestimin e veteranëve të UÇK-së në Maqedoninë e Veriut. “Pata kënaqësinë e veçantë të pres në takim kryetarin e Kuvendit të Maqedonisë së Veriut, Afrim Gashi, ku folëm për zhvillimet aktuale në dy vendet tona dhe thellimin e bashkëpunimit mes nesh. Në këtë takim shpreha shqetësimin lidhur me arrestimin e veteranëve të

UÇK-së në Maqedoninë e Veriut - veprim ky i papranueshëm që cenon raportet tona ndërshtetërore, me ç’rast kërkova që faktori shqiptar atje të angazhohet fuqishëm për ndaljen e këtyre përndjekjeve”, ka thënë Krasniqi pas takimit. Ai ka thënë se PDK-ja mbetet e përkushtuar për ruajtjen e raporteve të mira dhe fqinjësore me Maqedoninë e Veriut, sidomos me spektrin politik shqiptar në bashkërendimin e politikave të përbashkëta në të mirë të fuqizimit të shqiptarëve në rajon. “Kryetari Gashi i urova punë të mbarë, që si kryetar i Kuvendit të Maqedonisë së Veriut, të ndihmojë në realizimin e ambicieve dhe të

drejtave të qytetarëve shqiptarë atje”, është shprehur Krasniqi. Ndërkaq kryetari i Kuvendit të Maqedonisë së Veriut, Afrim Gashi, ka thënë se ishte kënaqësi e veçantë që në kuadër të vizitës zyrtare në Prishtinë, ta takojë kryetarin e Partisë Demokratike të Kosovës, Memli Krasniqi. “Diskutuam për zhvillimet e fundit politike në rajon, ku theksova rëndësinë e angazhimit të përbashkët për adresimin e sfidave rajonale dhe ndërkombëtare, si dhe avancimin e procesit të integritetit evropian, si çështje kyçe për të dyja vendet. Vlerësova rolin e rëndësishëm që ka luajtur dhe vazhdon të luajë PDK në këtë drejtim. Shkëmbyem pikëpamje mbi

mundësitë e forcimit të bashkëpunimit mes Maqedonisë së Veriut dhe Kosovës, veçanërisht në kuadër të Grupit Parlamentar, ndërsa në prag të zgjedhjeve parlamentare i urova një proces zgjedhor të suksesshëm, të drejtë dhe demokratik”, ka thënë Gashi.

**Gashi takon edhe Konjufcën, diskutojnë për bashkëpunimin ndërparlamentar**

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, i shoqëruar nga nënkryetarja e Kuvendit, Saranda Bogujevci, shefi i Kabinetit, Ilir Kërçeli, ambasadori Florian Qehaja dhe këshilltarët, ka pritur të hënën në takim kryetarin e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Afrim Gashi. Në pritjen që i bëri homologut Gashi, kryeparlamentari Konjufca shprehu bindjen se takimet dhe angazhimi i përbashkët i shërbejnë rritjes së bashkëpunimit të shkëlqyer midis Republikës së Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut, duke i konsideruar ato si përpjekje për më të mirën e qytetarëve tanë.

Në këtë takim kryetari Konjufca dhe kryetari Gashi diskutuan për aspekte të ndryshme të parlamentarizmit dhe folën për mundësitë e rritjes së bashkëpunimit midis institucioneve legislative. Gjithashtu, biseduan edhe për çështje të tjera të interesit të përbashkët, duke përfshirë rrugën e integritetit evropian, zhvillimin ekonomik, tregtar dhe stabilitetin e rajonit tonë. Kryetari Konjufca shtoi se bashkëkombësit tanë, vlerat dhe synimet e përbashkëta janë ato që qëndrojnë midis raporteve të tyre të shkëlqyera shtetërore si garanci e këtij bashkëpunimi të shkëlqyer dhe thellimit të tij. Kryetari i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Afrim Gashi, e falënderoi kryekuvendarin Konjufca për pritjen dhe shprehu gatishmërinë e plotë për të avancuar sa më shumë me projekte dhe punë të përbashkëta, të cilat çojnë në drejtim të përmbushjes së synimeve dhe interesave të vendeve tona. “Ishte nder i veçantë të takoj mikun tim, kryetarin e Kuvendit të Republikës Kosovës, z. Glauk Konjufca, gjatë një takimi zyrtar në Prishtinë. Ky takim shënoi një mundësi të shkëlqyer për të

# Përmbysja e madhe apo loja e madhe



**Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA**

**Je e mbaruar, senjora presidente:** Presidentja, deri dje e Albinin, tash e Kosovës, Sherife Osmani, në fjalimin e përmortshëm vjetor politik, në mungesë të sukseseve, sidomos në politikën e jashtme bëri përpjekje ta bëjë Kurban Albin Kurtin, ndryshe Pejgamberin e saj. Me një fjalor cic - mic, e gërvishte Albinin, pa ia përmendur emrin. Oportuniste, me kalkulator në gjuhë, mashtruese e sofistikuar, në përpjekje të ringjallet politikisht duke ia bërë funeralin politik Albin Kurtit siç ua kishte bërë më parë Fatmir Sejdiut dhe Isa Mustafës. Këta ia falën, Albinin nuk e falën! Sherife Osmani nuk është patriotë më e madhe se Albin Kurti, sipas meje nuk është fare patriotë. Në aspektin e njohurive politike Albin Kurti është Ajnshtajni për Vojsa Osmanin kurse në aspektin e mashtrimit dhe tradhtisë politike në luftë për pushtet, ajo është Ajnshtajne për Albinin. Jo se Albinin besën, sinqeritetin, respektin dhe korrektësinë e konsideron virtyt, përkundrazi është ana e errët e Albinin opozitar duke mos e realizuar asnjë premtim të dhënë. Kjo ka ndikuar dhe do të ndikojë në shembjen politike të VV-së dhe Albin Kurtit në zgjedhjet e ardhshme. Kjo shembje nuk ka të bëjë fare me fjalorin okult të Sherife Osmanit në Kuvendin e Kosovës për faktin se Vojsa Osmani do të shembet edhe më shumë pavarësisht se do të përpriqet të mbështetet në LDK-në të cilën e përgjysmoi, si patericë e Albin

Kurtit. Vojsa Osmanit nuk i besohet as kur ta tregon ditën në kalendar e lëre më për çështje patriotike apo politike. Albinin i kam besuar në fillim, tash nuk i besoj mësa Vjosës! Mirëpo, përkundër të gjithave duhet të pranohet se Albin Kurti e ka një të kaluar kombëtare kurse senjora presidente nuk ka bërë gjë për këtë vend përveç se ka përfituar, personalisht dhe familjarisht. Sidomos ka përfituar shumë dhe pameritueshëm "Llaskuci i Parë" e që në vendet normale quhet "Zotëriu i Parë".

**Ku mori në thua KM Kurti:** Albin Kurti ishte ndoshta KM më premtues i Kosovës pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës. Me një kapital të jashtëzakonshëm të votave, mbi 51 për qind, me një shtet të pavarur të njohur ndërkombëtarisht me mbi 110 shtete, me një infrastrukturë rrugore më të mirën në Ballkan, me një infrastrukturë shtetërore të konsoliduar në përputhje me kushtet, me një përmirësim të gjendjes ekonomike dhe sociale, pa asnjë kundërshtim të opozitës, u krijuan kushtet që Albinin të shkëlqejë, siç prisnim dhe besonim, edhe ata që nuk pajtoheshin me te. Po gabimi, nëse nuk ka qenë qëllimi i Albinin, ishte një qeveri invalide intelektualisht dhe profesionalisht ku gara mund të bëhet se cili ministër është më i dobët se tjetri dhe cili ministër është më hajn se tjetri e jo krahasimi në bazë të ndershmërisë apo profesionalizmit. Pastaj, u bë mbyllja hermetike e institucioneve ku informatat për opinionin shpërndahej vetëm pasi kaloi filtrat e një makuteje, Dejana Mihali që shndërroi në rrogëtarë dhe vartës patologjik tërë VV-në, burra dhe gra si dhe ata me shumë gjini. Nepotizmin familjar dhe

partiak e shndërruan në jetë a vdekje kurse korrupsionin e bënë vulë qeverisë. Albin Kurti, erdhën kinse me duar të pastra kurse po shkojnë, jo vetëm me duar të pista por me fytyrë katran të zezë. Që nga përfundimi i luftës nuk ka ndodhë që korrupsioni politik, moral, material, njerëzor dhe moral të mbrohet me aq vendosmëri dhe pafytyrësi se që e ka bërë Kurti, Sherife Osmani, dhe kabineti qeveritar plus deputetët që vet, ose është dëshmuar se kanë bërë vepra penale, ose janë nën hetime. Albin Kurti e ka dhunuar historinë duke filluar llogarinë e saj nga viti 2021 kur i fitoi zgjedhjet dhe duke bërë përpjekje t'i përzë nga historia krijuesit e vërtetë të historisë kombëtare, ushtarake, politike dhe shtetërore që tash po mbahen si pengje në Burgun Special të Gjykatës Speciale në Hagë, i themeluar vetëm për këtë qëllim. Kurti e fuqizoi politikisht dhe institucionalisht, Pandora Osmanin dhe tash kjo doli nga pakoja, për ta dëmtuar Kurtin, për dobi të saj dhe Llaskucit të Parë. Terri informativ mundëson hajni të mëdha prandaj Albin Kurti dhe kjo "Cubja e drejtësisë", luftën kryesore e bënë duke sulmuar prokurorin dhe gjyqësorin në ndërkohë që policinë e kapën keq dhe krejt me ndihmën e një injoranti të pashembullt dhe të paskrupullt. Politikën e jashtme e lanë në duar të një urrejtëse patologjike të UÇK-së, të burgosurve politikë shqiptarë dhe Bacë Adem Demaçi. Ministrinë e Punëve të Jashtme e shndërroi në qendër të prostitucionit diplomatik, pa asnjë njohje dhe pa asnjë anëtarësim në organizatat ndërkombëtare. Sikur që e bëri inekzistente këtë ministri përveç familjarizimit, turizmit diplomatik, korrupsionit të konkursit dhe mohimit të mundësive të barabarta. Bisedimet "teknike" dhe politike ia

besoi një krijese që vetëm anatomia e njeh si njeri, tjera elemente nuk i ka. Ministrinë e Financave ia besoi një rrenci dhe mashtruesi që, po të ishin këto kritere përcaktuese për fitimin e Çmimit Nobel, do ta siguronim këtë çmim gjatë tërë mandatit të tij. Mos të flasë për rozetat dhe pecat, as në Çernobil nuk do të gjeni këso raste. Ministrinë e Kulturës dhe Zhëndetësisëvia ka besuar balenave të korrupsionit të cilët i mbron më shumë se që e ka mbrojtur Ismail Qemali, Deklaratën e Pavarësisë. Është sjell panjerëzishëm me opozitën, shumë poshtërisht dhe hakmarrës me Hashim Thaçin, Kadri Veselin dhe Jakup Krasniqin duke veçuar Rexhep Selimin. E ka përçarë faktorin politik në Luginë të Preshevës, ka defaktorizuar shqiptarët në Maqedoni të Veriut me të vetmin qëllim ta luftojë Ali Ahmetin. Tash iu bë i mirë dhe president historik Ibrahim Rugova kurse mashtron publikun se është student i Bacë Adem Demaçit. FSK-në dhe AKI-në ia ka lënë të udhëhiqet, nën hije nga "hajni i pasullit". Më të mira i ka marrëdhëniet me Mickoskin dhe Vuçiqin se me Edi Ramën. I ka përzënë dhe defaktorizuar të gjitha vlerat kombëtare kurse nderon me vende pune dhe privilegje vlerat jugosllave dhe serbe, me të cilat i ka mbjell institucionet. Asnjë investim kapital përveç dështimeve kapitale. Ka edhe shumë të tjera, për më vonë. Njeriu që ka urrejtje dhe hakmarrje kurse Albinin i ka të dyja, edhe për eksport. Kur flasë për VV-në nënkuptohet se flasë për Albinin sepse ai është forma dhe përmbajtja e kësaj partie, pa Albinin nuk ka as parti e as lëvizje. Mendermethënë "Alternativa" e Zdravo Mimosës nuk i siguron as edhe një grusht vota kurse edhe më shumë mendermethënë e

mega mashtruesve të kondomerisë Guxo, bashkë me haxhiqamilët, nuk do të votohen as nga Zdravo Mimoza e lëre më të tjerët. Prandaj, si miza kali po mbijetojnë në ambientin e një lokacioni të paraparë për miza në të pasmet, tash bukur të majmura të Albin Kurtit.

**Si reflektohet kjo në zgjedhjet e ardhshme:** Nuk besoj se VV do të mbërrij as 30 për qind nëse nuk ndodhë diçka e madhe dhe e papaparë në ndërkohë. Nuk besoj se PDK dhe LDK mbesin nën 22 - 24 për qind sikur që nuk e besoj se AAK bie nën 8.5 për qind. Kam besuar se Lista për Familjen i fiton, së paku 6 për qind, me përçarjet e fudit, më është mjegulluar parashikimi im. Ka kohë deri në atë kohë.

**Urime për festat kombëtare dhe jugosllave:** Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit, Rexhep Selimit, Salih Mustafës, Pjetër Shalës dhe pengjeve tjera të Hagës ua urojë Festën e 28 Nëntorit, Festën e Flamurit Kombëtar, Festën e të gjithë shqiptarëve. Këtë festë ua uroj të gjithë luftëtarëve të lirisë të të gjitha luftërave kombëtare, veteranëve dhe invalidëve të luftës çlirimtare, Heronjve të Luftës dhe të Paqes, të Burgosurve Politikë... idealistëve që ende janë gjallë... Rreth Flamurit të përbashkuar, me një dëshirë dhe një qëllim... Në anën tjetër, ua uroj Festën e 29 Nëntorit, Festa Shtetërore e Jugosllavisë kriminelëve Mehmet Loci, Sahit Ismajli, Zymer Zymeri dhe shokëve të tyre sikur edhe anëtarëve të kabinetit Kurti, këshilltarëve, ambasadorëve dhe bartësve të posteve tjera shtetërore e që mendësinë e kanë jugosllave dhe serbe me himnin e tyre të zemrës: "Hej sloveni, josh ste zhivi...". Jam përkrahës i madh i diversitetit!



konfirmuar marrëdhëniet miqësore mes Maqedonisë së Veriut dhe Kosovës, si dhe për të theksuar angazhimin serioz për forcimin e dialogut dypalësh dhe bashkëpunimit ndërparlamentar. Diskutuam për projektet e përbashkëta, progresin dhe sfidat me të cilat përballem vendet tona në rrugën për integrim në BE, ku theksova

mbështetjen tonë të palëkundur për Kosovën në procesin e saj të integritit në organizatat ndërkombëtare. Falënderova Glaukun për pritjen e ngrohtë vëllazërore, dhe shprehëm angazhimin tonë të ndërsjellë për të thelluar bashkëpunimin mes institucioneve tona dhe grupeve parlamentare", ka thënë Gashi pas takimit.

## Kurti dhe Gashi: Bashkëpunimi i afron më shumë qytetarët e dy vendeve

Edhe kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka prituri në takim kryetarin e Kuvendit të Maqedonisë së Veriut, Afrim

Gashi, me të cilin ka biseduar për zhvillimet politike dhe bashkëpunuese në të mirë të të dy shteteve. "Një javë pasi ishim nikoqirë të Qeverisë së Maqedonisë së Veriut për mbledhjen e dytë të përbashkët qeveritare, sot kisha nderin dhe kënaqësinë ta mirëpres kryetarin e Kuvendit të Maqedonisë së Veriut, Afrim

Gashi. Bashkëpunimi parlamentar mund t'i çojë më tej marrëdhëniet bilaterale ndërmjet dy shteteve tona dhe të afrojmë edhe më shumë qytetarët e dy vendeve. Andaj vizitat si kjo janë tejet të vlefshme, e grupet parlamentare të miqësisë, tejet të rëndësishme", ka thënë Kurti pas këtij takimi.

## Komuna e Gjilanit subvencionon me 138 mijë euro 29 përfituesit e mjedrës dhe boronicës

GJILAN, 25 NËNTOR - Kryetari i komunës së Gjilanit, Alban Hyseni, bashkë me drejtorin për Bujqësi, Bajram Isufi, kanë vizituar fermerin Enver Sherifi nga fshati Malisheva. I pari i Gjilanit tha se kjo

vizitë te profesori Enver Sherifi, një punëtor i zellshëm e i përkushtuar jo vetëm në arsim, por edhe në bujqësi, është e veçantë. "Profesori Enver është një nga 29 përfituesit e

programit tonë të subvencionimit të mjedrës dhe boronicës, një mundësi kjo e shkëlqyer për fermerët e Gjilanit që të depërtojnë në tregje të reja", tha kryetari Alban Hyseni.

Më tej ai shtoi se falë investimit prej 138 000 eurosh, kanë arritur të mbështesin këta fermerë me fidanë, sisteme të ujitjes dhe materiale për modernizimin e fermave.



## SBASHK-u nis me veprime sindikale, proteston më 4 dhjetor

PRISHTINË, 25 NËNTOR - Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (SBASHK) ka njoftuar se më 4 dhjetor do të organizojë protestë. Ky vendim u mor pas takimit të Këshillit Drejtues të SBASHK-ut, në të cilin u analizua situata aktuale dhe u shprehën kritika të ashpra ndaj qeverisë dhe Ministrisë së Arsimit.

Në një njoftim për media, SBASHK-u tha se kritikën lidhen me "mungesën e dialogut dhe qasjen e gabuar ndaj kërkesave legjitime të anëtarësisë", duke theksuar bllokimin e negociatave për Kontratën e Re Kolektive të Arsimit nga ana e ministres Nagvci. "Në orët e mbrëmjes së të dielës është mbajtur takimi konsultativ me kryetarët e nivelit komunal

sindikal e të universiteteve dhe të gjithë kanë ripërsëritur vendimin e Këshillit Drejtues për të filluar me veprime sindikale. U vendos që veprimi i parë sindikal të jetë protesta më 4 dhjetor me pjesëmarrjen e kryetarëve dhe kryesive nga të gjitha shoqatat sindikale që nga çerdhet e deri në universitete, të anëtarëve të Këshillit Drejtues, të kryetarëve e kryesive të nivelit komunal sindikal e të universiteteve dhe të kryesive qendrore duke qenë rreth 2000 protestues", thuhet në njoftim.

SBASHK-u bën me dije se kjo protestë do të nisë para Ministrisë së Arsimit e pastaj do të marshohet drejt objektit të Qeverisë dhe të Kuvendit të Kosovës. "Ky do të jetë veprimi i parë sindikal pas protestës së 1 majit të këtij viti dhe



përppjekjeve të vazhdueshme për dialog, dhe do të vazhdohet edhe me veprime të tjera sindikale, duke mos përjashtuar edhe grevën në

tërë sektorin e arsimit nëse Qeveria dhe në veçanti Ministria e Arsimit nuk reflekton dhe nuk nisë negocimin për Kontratën e re

Kolektive të Arsimit, e cila është bazë që siguron respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve të arsimit dhe nuk ka shtet në botë që pretendon të jetë demokratik e që nuk ka të nënshkruar Marrëveshjen Kolektive në nivel vendi dhe të Kontratave kolektive të sektorëve, por në Kosovë kjo po ndodh dhe prandaj duke respektuar vullnetin e anëtarësisë jemi të detyruar të nisim me veprime sindikale", thuhet tutje në njoftim. SBASHK-u thekson se për gjithë angazhimet dhe përkushtimin ndaj kërkesave të anëtarësisë gëzon mbështetjen e fuqishme të Unionit të Sindikatave të Evropës, që ka 11 milionë anëtarë dhe të Internacionales Botërore të Arsimit, që ka 32 milionë anëtarë nga e tërë bota.

## Nënkoloneli i ushtrisë shqiptare shpallet 'Qytetar Nderi' i Deçanit

DEÇAN, 25 NËNTOR - Për nder të përvjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë, komuna e Deçanit ka nderuar nënkolonelin e ushtrisë shqiptare, Besnik Fana, duke ia dhënë titullin "Qytetar Nderi".

Në mbledhjen solemne për festat e Nëntorit, kryetari i Deçanit, Bashkim Ramosaj, ka thënë se në këtë mënyrë po nderojnë të gjithë ushtrinë shqiptare. "Historia jonë është nëntori dhe marsi. Përppjekjet e shqiptarëve për liri dhe pavarësi krijuan ngjarje që mbetën në kujtesën tonë, për të mos u harruar kurrë. Data 28 nëntor e vitit 1997 është data e shfaqjes së ushtrisë sonë më të lavdishme ndër shekuj - UÇK-së. Një betim për të qenë gjithmonë bashkë e për t'i mbrojtur idealet kombëtare. Kemi përzgjedhur nënkolonelin Besnik Fana jo si emër i përveçëm, por si emër ku nderojmë luftëtarin shqiptar dhe ushtrinë e Shqipërisë", ka thënë Ramosaj.



Nënkoloneli Besnik Fana, i cili është nderuar me këtë titull, është zotuar për punë të pakursyer në të mirë të vendit. "Marrja e titullit qytetar nderi, sidomos në Deçan, më besoni që i kalon kufijtë e emocionit. Një vend që historinë e kombit shqiptar e ka shkruar e rishkruar me gjak sa herë që e ka kërkuar nevoja. Qytet që është djegur shumë herë, por sa herë është djegur është bërë më i fortë e ndërtuar më i bukur. Si ushtarak i shqiptarisë dhe si qytetari më i ri i juaji, ju premtoj që angazhimi dhe përkushtimi për të mirën e këtij vendi do të jetë i pakursyer sa herë të jetë nevoja. Zoti e bekoftë popullin shqiptar!", ka thënë Fana. Besnik Fana është nderuar me mbi dhjetë medalje të ndryshme. Ai e ka filluar karrierën në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë, ka marrë pjesë në tetë misione, Irak, Afganistan dhe Kosovë.

## Lirohet edhe një hapësirë publike në kryeqytet



PRISHTINË, 25 NËNTOR - Komuna e Prishtinës ka njoftuar të hënën se është rrënuar një lokal i ndërtuar në hapësirën e kalimit të dedikuar për banorët e kompleksit "Santea" në lagjen Dardania. Në njoftim theksohet se Inspektorati i Kryeqytetit vazhdon aksionet për lirim të hapësirave të uzurpuara publike në Prishtinë.

## Vazhdon prezantimi i projektit të klasifikimit të mbeturinave në Podujevë

Podujevë, 25 nëntor - Komuna e Podujevës, në bashkëpunim me GIZ-in gjerman, ka vazhduar prezantimin e projektit për

klasifikimin dhe riciklimin e mbeturinave. Pas shkollave, çështja e klasifikimit të mbeturinave është diskutuar edhe me punëtorët e

administratës komunale. Klasifikimi i mbeturinave tashmë ka filluar të realizohet në disa shkolla, kurse deri në fund të vitit

planifikohet të përfshihen të gjitha shkollat dhe klasifikimi do të bëhet standard në komunën e Podujevës.



## Kuvendi të hënën e ardhshme debaton për mandatin qeverisës të Kurtit

PRISHTINË, 25 NËNTOR - Kuvendi i Kosovës pritet të mbajë tri seanca plenare, duke përfshirë një për raportimin e mandatit katërvjeçar të Qeverisë së Kosovës. Kështu bëri me dije pas mbledhjes së Kryesisë, në një konferencë për medie, shefi i grupit parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Besnik Tahiri, i cili tha se seanca për këtë raportim do të mbahet më 2 dhjetor. Përkrahje për këtë nismë ka dhënë edhe shefi i grupit parlamentar i Lidhjes

Demokratike të Kosovës (LDK), Arben Gashi, i cili ka theksuar se seanca më e rëndësishme do të jetë ajo e 2 dhjetorit, ku do të diskutohet për qeverisjen e kryeministrit Albin Kurti. Gashi shtoi se kjo nismë është mbështetur nga LDK-ja dhe se fundi i kësaj legjislature do të përmbyllet me mbajtjen e zgjedhjeve të reja. Ndërkohë, shefja e grupit parlamentar e Lëvizjes Vetëvendosje (LV), Mimoza Kusari-Lila, u shpreh se kërkesa e opozitës për një seancë më 2

dhjetor është një kërkesë e përsëritur që daton që nga marsi i këtij viti. Ajo bëri me dije se do të mbahen dy seanca të tjera më 5 dhjetor, një në orën 10:00, tjetra në orën 14:00. “Tri seanca, e para një kërkesë e opozitës gati e vjetruar, e cila është bërë në muajin mars të këtij viti. Më 2 dhjetor do të mbahet seanca për mandatin e plotë të qeverisjes Kurti. Kurse më 5 dhjetor do të ketë dy seanca, njëra në orën 10:00, tjetra në orën 14:00”, ka thënë Kusari-Lila.



## Kosova po ndërton stacione të reja policore në veri

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 25 NËNTOR - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, njoftoi më 25 nëntor se është vendosur gurthemeli për ndërtimin e një nënstacioni policor në fshatin Izvor të Zveçanit në veri të Kosovës.

“Në objektin e ri, që presim të ndërtohet shumë shpejt, do të shërbejë policia kufitare”, shkroi ai në “Facebook”.

Në vendosjen e gurthemelit për ndërtimin e këtij stacioni morën pjesë ministri i Punëve të Brendshme të Kosovës, Xhelal Sveçla dhe drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Gazmend Hoxha. Ndërkaq, sipas një njoftimi të Qeverisë së Kosovës, projekti për këtë nënstacion kap vlerën e rreth 700 000 eurove.

Kurti tha se javën e kaluar është vendosur edhe një gurthemel për stacionin e policisë mbi urën e lumit Bistrica, e cila ndodhet në rrugën kryesore që çon në kalimin kufitar të Jarinjës. Në këtë pikë ndodhen pjesëtarë të njëjseve speciale dhe të rregullta të Policisë së Kosovës.

Ministri i Brendshëm, Xhelal Sveçla, më 23 nëntor, gjatë vendosjes së gurthemelit për ndërtimin e stacionit në Bistricë, tha se ky “objekti i ri e modern do të jetë në shfrytëzim të pjesëtarëve të Policisë së Kosovës të cilët nga ky vend po shërbejnë prej gati dy vjetësh në luftimin e çdo



kriminaliteti, mbrojtjen e kufirit tonë e për sigurinë e përgjithshme të republikës sonë”. “Do të vazhdojmë pa u ndalur në ngritjen dhe forcimin e kapaciteteve tona për të përballur me sukses çdo sfidë që mund të na dalë përpara”, shtoi ai.

Nga ana tjetër, përfaqësuesit e komunitetit serb, që është shumicë në veri të Kosovës, kundërshtojnë ndërtimin e stacioneve policore ose bazave policore, me arsyetimin se ata janë të ekspozuar ndaj “presioneve dhe diskriminimit” nga ana e policisë. Gjithashtu, sektori

civil serb ka kërkuar kohët e fundit nga komuniteti ndërkombëtar që t’u kushtojë vëmendje ankesave të qytetarëve për sjelljen e Policisë së Kosovës, duke cilësuar atë si “joprofesionale” dhe “të politizuar”.

Drejtori i Zyrës për Kosovën në Qeverinë e Serbisë, Petar Petković, e ka vlerësuar ndërtimin e stacioneve të reja si “një mjet shtesë për shtypjen dhe dëbimin e popullatës serbe”. Ai ka deklaruar se autoritetet e Kosovës “kanë ndryshuar në mënyrë të dhunshme strukturën etnike të policisë” në veri të Kosovës dhe

ka potencuar se Marrëveshja e Brukselit parashikon që në këtë pjesë të dislokohen policë nga radhët e komunitetit serb. Në fillim të nëntorit 2022, mbi 500 policë nga radhët e komunitetit serb në veri të Kosovës dhanë dorëheqje si pjesë e një aksioni kolektiv për t’u larguar nga institucionet e Kosovës për shkak të vendimit të Qeverisë së Kosovës për konvertimin e targave të makinave nga ato të lëshuara nga Serbia, në ato të Kosovës. Që nga ajo kohë në veri të Kosovës kanë ndodhur kriza të shumta, që kulmuan me një sulm të armatosur të një grupi

të serbëve ndaj Policisë së Kosovës në shtator 2023, kur u vra një polic i Kosovës. Ndërkohë, në veri janë dërguar kryesisht policë nga komuniteti shqiptar, si dhe pjesëtarë të njëjseve speciale të Policisë së Kosovës.

Gjithashtu, Qeveria e Kosovës në fund të majit të këtij viti mori vendimin përfundimtar për shpronësimin e mbi 100 parcelave në komunat me shumicë serbe, Leposaviq dhe Zubin Potok, për ndërtimin e stacioneve dhe bazave të policisë.

Shtetet e Quint-it - Shtetet e Bashkuara, Franca, Gjermania, Italia dhe Mbretëria e Bashkuar - së bashku me Zyrën e Bashkimit Evropian në Kosovë dhe Misionin e Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Kosovë (OSBE), atëbotë kishin shprehur shqetësimin për këtë vendim të Qeverisë së Kosovës, duke shtuar se shpronësimi duhet të vlerësohet në kuadër të ligjshmërisë, të drejtave të njeriut dhe interesit publik, dhe jo në bazë të përkatësisë etnike të qytetarëve.

Çështja e shpronësimit në veri për ndërtimin e stacioneve të policisë ose bazave u përfshi edhe në raportin e përfaqësueses së Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës për Kosovën, Dora Bakoyannis, ku përshkruhet si çështje e rëndësishme për sundimin e ligjit dhe që ka “pasoja të gjera politike”.

## Osmani në Forumin Ndërkombëtar në Halifax: Kosova, një ndër sukseset më të mëdha në historinë moderne

PRISHTINË, 25 NËNTOR - Presidentja e Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani, ka marrë pjesë në panelin përmbyllës me temën “Epoka e optimizimit: tani varet nga ne”, në Forumin Ndërkombëtar në Halifax. Në “Facebook”, Osmani ka shkruar se ka diskutuar për shembullin e Kosovës, si një

ndër sukseset më të mëdha në histori. “Në panelin përmbyllës me temën “Epoka e optimizimit: tani varet nga ne”, në Forumin Ndërkombëtar në Halifax, diskutova për shembullin e Kosovës, si një ndër sukseset më të mëdha në histori, si bashkëdyzim i qëndrueshmërisë së popullit

të Kosovës në njërin anë dhe fuqisë së aleancave të bazuara në vlera, në anën tjetër”, ka shkruar presidentja Osmani. Në kuadër të kësaj vizite, Osmani do të zhvillojë takime dypalëshe me presidentin e Republikës së Kolumbisë, Gustavo Petro, si dhe me presidentin e Senatit të Kolumbisë, Efrain Cepeda.



## Bëhet inaugurimi i fillimit të punimeve për ndërtimin e Parkut Industrial në Drenas

DRENAS, 25 NËNTOR - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, bashkë me ministren e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, Rozeta Hajdari, morën pjesë në inaugurimin e fillimit të punimeve për ndërtimin e Parkut Industrial në Drenas. Kryeministri Kurti me këtë rast tha se ajo çfarë po angazhohemi me fokus të posaçëm është ta bëjmë kalimin nga zonat ekonomike të pafunksionalizuara drejt parqeve industriale të specializuara, parqeve industriale të gjelbra dhe parqeve të teknologjisë e të inovacionit. Gjithashtu,

kryeministri tha se “këto parqe industriale janë dëshmi që ne edhe besojmë në konkurrencën e lirë midis bizneseve, por mundësojmë edhe bashkëpunimin midis bizneseve për vlerë të shtuar”.

Parku Drenas 2 pritet të jetë sa më shumë i gjelbër, me qasje në energji të ripërtërishme, me objekte të menaxhimit të mbeturinave e të ngjashme dhe do të jetë në shërbim të bizneseve tona me veprimtari inovative për ta rritur riciklimin në prodhim dhe për të kontribuar në zhvillimin e industrisë së gjelbër.

I iniciuar nga Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, si dhe nga agjencia KIESA, ky park do të ketë një sipërfaqe prej 36.5 hektarësh, do të jetë në pronësi të qeverisë, do të ketë një investim prej 7,7 milionë eurosh e hapësirë për 50 biznese prodhuese, duke përfshirë ato me veprimtari inovative që do të kontribuojnë dhe përfitojnë nga ekonomia qarkore.

Në këtë ngjarje të pranishëm ishin edhe kryetari i komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci dhe deputeti i Kuvendit të Kosovës, Enver Dugolli.



## Hoti: Me miratimin e buxhetit janë bërë dy shkelje, presidentja do të duhej t'ia kthente Kuvendit këtë ligj

EPOKA  
ERE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 25 NËNTOR - Deputeti Avdullah Hoti ka thënë se Kuvendi i Kosovës e miratoi Ligjin e Buxhetit për 2025 me dy shkelje ligjore, pa i adresuar nevojat kryesore dhe pa i trajtuar dhjetëra kërkesa buxhetore. Ai ka thënë se sikur të funksiononte si duhet rendi kushtetues, Zyra e Presidencës do t'ia kthente Kuvendit këtë ligj për shqyrtim të tretë. “1. Shkeljet ligjore lidhen me nenin 33, i cili e ndryshon ligjin e pagave duke e shtrembëruar strukturën hierarkike të pagave, si dhe me nenin 35 me të cilin ndryshohet ligji i tatimit në pronë. Të dyja këto raste mund të adresohen vetëm duke ndryshuar ligjet përkatëse. 2. Mosadresimi i nevojave kryesore buxhetore lidhet me buxhetimin e pamjaftueshëm të: (i) pagave, pensione dhe skemave sociale për shkak të inflacionit; (ii) projekteve kapitale që kanë mbetur në gjysmë për katër vite; (iii) skemës së sigurimeve shëndetësore, arsimit dhe shëndetësisë në përgjithësi; (iv) kontratës kolektive, për të cilën komunat po paguajnë përmes vendimeve përmbartimore; (v)



ushtrisë për të përmbushur planin e avancimit të dakorduar me aleatët etj. 3. Në Komisionin për Buxhet kanë arritur dhjetëra kërkesa të organizatave buxhetore qendrore e lokale dhe nga deputetët. Përveç disa kërkesave të deputetëve të komuniteteve, të cilat janë miratuar pasi duket se ata deputetë e kanë kushtëzuar

vetën e tyre me miratimin e kërkesave të tyre, asnjë kërkesë tjetër nuk është miratuar. Mosmiratimi në veçanti i kërkesave të institucioneve të pavarura kushtetuese bie ndesh me parimin e pavarësisë kushtetuese të atyre institucioneve. Kurrë në historinë e shkurtër të shtetit të Kosovës nuk ka ndodhur të miratohet kështu buxheti pa

asnjë konsideratë ndaj deputetëve dhe organizatave buxhetore. E mira është se ky mandat katastrofal sa i përket performancës buxhetore po mbaron, dhe se qeveria e ardhshme duhet me prioritet ta ndryshojë këtë buxhet”, ka shkruar Hoti në “Facebook”. Ai ka thënë se buxheti prej 11.4 miliardë eurosh në këtë mandat qeverisës 2021-2024 është

shpenzuar rreth 40 % në subvencione. “Dështimi kolosal është tek investimet kapitale, ku janë planifikuar 3 miliardë euro e janë shpenzuar vetëm 1.2 miliardë euro. Si rezultat, ekonomisë së Kosovës i mungojnë 1.8 miliardë euro”, ka thënë Hoti. Ai ka shtuar se si rezultat i dështimit për menaxhim të buxhetit dhe mungesës totale të politikave fiskale, rritja ekonomike ka qenë më e ulët në shumë vjet. “Rregullatorët ekonomikë janë pasivizuar. Ka mungesë të dialogut me sektorin privat dhe sindikatat. Kushtet e të bërit biznes janë përkeqësuar. Është thelluar deficitit tregtar me rreth 2 miliardë euro. Rreziqet fiskale nga ndërmarrjet publike mbesin të larta. Standardi i jetës është përkeqësuar pasi barra për buxhetin e familjeve është rënduar. Energjia është shtrenjtuar 117 %. Nuk është ndërtuar asnjë kapacitet i ri energjetik. Në arsim u përkeqësuan rezultatet në testin PISA. Prandaj, është tepër e rëndësishme që në qeverinë e re fillimisht të kthehet ligjshmëria në shfrytëzimin e buxhetit, e mandej të planifikohet buxheti në përputhje me nevojat dhe prioritetet”, ka deklaruar Hoti.

## AAK-ja: Kryeministri Kurti ka ndikuar në zgjedhjen e bordeve të KRU-ve

PRISHTINË, 25 NËNTOR - Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), përkatësisht Departamenti për Ujë dhe Politika Mjedisore, ka thënë se shumica e bordeve të emëruara në Kompanitë Rajonale të Ujësjellësit (KRU) në Kosovë kanë dështuar të jenë profesionale dhe shpesh janë përbërë nga individë pa përvojë të mjaftueshme në menaxhimin

e sektorit të ujit. Përmes një komunikate për medie, Departamenti për Ujë dhe Politika Mjedisore i AAK-së ka thënë se faktori që ka ndikuar në këtë situatë është roli i qeverisë, veçmas i kryeministrit Kurti. “Një nga faktorët kryesorë që ka ndikuar në këtë situatë është roli i qeverisë, veçanërisht i kryeministrit Albin Kurti. Pavarësisht premtimeve të

përsëritura për përmirësimin e gjendjes në sektorin e ujit përmes instalimit të bordeve profesionale, këto premtime nuk janë materializuar sipas pritshmërive. Në të vërtetë, përzgjedhja e kryesuesve dhe anëtarëve të bordeve shpesh është bërë pa ndjekur një proces transparent dhe të bazuar në merita profesionale”, thuhet në komunikatën e AAK-së.





# Angela Merkel: Putini? E dija, s'ka qenë kurrë mik i Evropës

Unë i dija shumë mirë qëllimet e Presidentit Putin. I ka shprehur gjithmonë si publikisht ashtu edhe në biseda konfidenciale. E dija që nuk kishim të bënim me një mik të Europës. Pyetja ishte vetëm si të reagonim. Përgjigja ime nuk ishte që të mos kisha

më asnjë marrëdhënie me Putinin, por përkundrazi të përpiqesha të parandaloja pushtimin e Ukrainës përmes bisedimeve, ndonjëherë me shumë polemika, në të cilat nuk përdora asnjëherë lojëra fjalësh. Ka funksionuar për një farë kohë. Me fillimin e luftës së

Rusisë kundër Ukrainës, situata ka ndryshuar rrënjësisht. Gëzimi më i madh i jetës sime – fundi i Luftës së Ftohtë, rënia e Murit, ribashkimi gjerman dhe uniteti i Evropës – për Putinin, nga ana tjetër, lidhen me fatkeqësinë më të madhe të shekullit të 20-të, fundin e

Bashkimit Sovjetik. Prandaj, pikëpamjet tona ishin diametralisht të kundërta. Putini po përpiqej ta bënte Rusinë sërish një fuqi të madhe. Por ai nuk mundi ta bënte atë në nivel ekonomik, përmes mirëqenies për të gjithë. Në vend të kësaj ai u përpoq me

metodat e mësuara në shërbimin sekret, KGB, përmes forcës ushtarake dhe nacionalizmit rus. Kaq shumë nga shpresat që kishim në vitin 1990, se Rusia do të merrte gradualisht rrugën e demokratizimit, nuk janë realizuar. / bota.al



## Çfarë është pushteti për Angela Merkelin

Ish kancelarja e Gjermanisë, Angela Merkel ka dalë nga periudha e gjatë e heshtjes dhe ka dhënë një intervistë të gjatë dhe pothuaj shteruese, për të përditshmen italiane, "Corriere della Sera". Në vijim bota.al do të botojë pjesët më të rëndësishme të intervistës

së gruas së hekurt, e cila drejtoi për 16 vite me radhë shtetin më të fuqishëm të ashkimit Evropian, dhe që ka lënë një shenjë të fortë në politikën botërore. Kishte një arsye për zhdukjen pothuajse totale të Angela Merkelit: për dy vjet ajo iu

përkushtua shkrimit të kujtimeve të saj me Beate Baumann, gruan që ka qenë hija e saj në politikë që nga viti 1992. "Liria" titullohet libri, i cili del të martën në tridhjetë vende. Në libër gjejmë kujtimet e saj, RDGJ-në, Putinin, Trumpin,

Berlusconi, por është gjithashtu mbrojtja e saj, një përgjigje ndaj akuzave: dhe ajo duket se nuk është penduar.

### Mbi pushtetin

Për mua, pushteti është

mundësia për të formësuar diçka. Të kesh mazhorancë, të marrësh vendime që lënë gjurmë së bashku me njerëzit që kanë marrë mandatet e tyre. Ndërtimi i mazhorancave, bashkimi i tyre, gjetja e kompromiseve. Ky është pushteti. / bota.al

**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT  
PILKINGTON Inver  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



## KOK-u dënon sulmin fizik ndaj trajnerit Migjen Shala

PRISHTINË, 25 NËNTOR - Komiteti Olimpik i Kosovës e ka pritur me shqetësim dhe indignatë të thellë incidentin e ndodhur gjatë turneut të kikkoksit në Cetinje të Malit të Zi, ku gjyqtari i kikkoksit, Fegja Terbonja nga Bosnja e Hercegovina, sulmoi fizikisht trajnerin nga Kosova, Migjen

Shala. KOK-u dënon ashpër incidentin e ndodhur, e sidomos kur shkaktoi i kësaj bëhet gjyqtari, roli i të cilit është ndarja e drejtësisë në ring, promovimi i respektit dhe "fair-play". "KOK-u, pas kontakteve dhe koordinimit me Federatën e Kikkoksit të Kosovës, ka kontaktuar

menjëherë me drejtuesit e Komitetit Olimpik të Malit të Zi, në vendin e të cilëve u zhvillua turneu, dhe me Komitetin Olimpik të Bosnjë-Hercegovinës, nga të cilët ka kërkuar marrjen e masave ndaj gjyqtarit! Njëkohësisht, i shprehim mbështetjen tonë trajnerit dhe ekipit të

kikkoksit, duke theksuar se siguria dhe integriteti i sportistëve dhe trajnerëve duhet të jenë kryeprioriteti i çfarëdo ngjarje sportive", thuhet në njoftimin e KOK-ut. Komiteti Olimpik i Kosovës më pas ka uruar që raste të tilla të mos shohim më në ngjarjet sportive, me besimin se



shkaktarët e dhunës të mos jenë më të pranishëm në ngjarjet sportive.

# Drita me përmbysje fiton derbin ndaj Llapit

**EPOKA E RE** Veton ZYMBERI

GJILAN, 25 NËNTOR - Skuadra e Dritës e ka fituar me përmbysje derbin ndaj Llapit (3-1) në ndeshjen që u zhvillua të hënën në Gjilan. Ishte skuadra mysafire që kaloi e para në epërsi me golin e Blend Baftiut në minutën e 22-të. Pjesa e parë përfundoi me këtë rezultat, derisa në pjesën e dytë u shënuan edhe tre gola të tjerë. Në minutën e 68-të, Albert Dabiqaj e realizoi golin e barazimit, kurse shtatë minuta më vonë i njëjti futbollist e kaloi Dritën në epërsi me rezultat 2-1. Në minutat shtesë në skenë doli edhe një herë Dabiqaj që realizoi golin e tretë personal

dhe të katërtin në ndeshje për rezultatin përfundimtar 3-1. Pas kësaj ndeshjeje, Drita përforcon pozitën e parë me 31 pikë. Në anën tjetër, Llapi mbetet në kuotën e 16 pikëve dhe renditet në pozitën e dhjetë. Ndeshja tjetër derbi në mes të Prishtinës dhe Ballkanit që u zhvillua të dielën në stadiumin "Fadil Vokrri" ka përfunduar baras 1-1. Mysafirët që janë kampionë në fuqi të Superligës kaluan në epërsi me anë të Bleart Tolajt, i cili realizoi gol të bukur në minutën e 32-të. Vendasit nuk u dorëzuan dhe shënuan golin e barazimit pas një ore lojë. Realizues ishte Leotrim Kryeziu. Në vijim të ndeshjes rastet nuk munguan, por gola të tjerë nuk pati dhe ndeshja



përfundoi me rezultat 1-1. Pas kësaj ndeshjeje, Ballkani vazhdon ta mbajë pozitën e dytë në tabelë me 26 pikë, ndërsa Prishtina renditet në vendin e katërt me 22 pikë.

Ndeshja tjetër që u luajt të dielën në mes të Suharekës dhe Ferizajt përfundoi baras pa gola (0-0). Në këtë xhiro Malisheva arriti një fitore të rëndësishme ndaj Dukagjinit

SUPERLIGA	
Drita - Llapi	3-1
Prishtina - Ballkani	1-1
Malisheva - Dukagjini	2-1
Suhareka - Ferizaj	0-0
Feronikeli '74 - Gjilani	0-3
Tabela	
	Pikë
1. Drita	31
2. Ballkani	26
3. Malisheva	25
4. Prishtina	22
5. Suhareka	19
6. Gjilani	17
7. Dukagjini	17
8. Llapi	16
9. Ferizaj	15
10. Ferizaj '74	3

(2-1), ndërsa Gjilani si mysafir dominoi përballë Feronikelit '74 (0-3).

## Sonte superpërballja Bayern - PSG



MUNICHEN, 25 NËNTOR - Sonte (e martë) në "Allianz Arena" do të zhvillohet një ndeshje interesante në Ligën e Kampionëve në mes të Bayern Munchenit dhe Paris Saint-Germainit. Të dyja këto klube gjigante janë në presion për të marrë rezultat pozitiv, pasi nuk janë në pozicion aspak aq të mirë. Bayerni është në vendin e 17 në tabelë, pasi ka marrë gjashtë pikë nga katër ndeshjet evropiane këtë sezon, ndërsa PSG-ja është në pozitën e 25-të, me skuadrën e Luis Enrique që ka mbledhur vetëm katër pikë nga katër ndeshjet fillestare. Trajneri

Vincent Kompany ka thënë se Bayerni po shijon momentin në Bundesliga, ndërkohë që është gati edhe për Ligën e Kampionëve. "Kur fiton 3-0 është normale që duhet të vlerësohen edhe pse e dimë që nuk është e lehtë. Në këtë ndeshje patëm 33 goditje në portë, por qëndruam të durueshëm derisa gjetëm golat. E di se sa ishte fitorja, është e rëndësishme dhe e vlerësoj shumë, duke menduar edhe për sfidën e radhës në Ligën e Kampionëve ndaj PSG-së", ka thënë Kompany. Ndërsa një tjetër ndeshje interesante pritet të

TË MARTËN TAKOHEN:	
18:45	Slovan Bratislava - AC Milan
18:45	Sparta Prague - Atletico Madrid
21:00	Barcelona - Brest
21:00	Bayer Leverkusen - RB Salzburg
21:00	Bayern Munich - Paris Saint-Germain
21:00	Inter - RB Leipzig
21:00	Manchester City - Feyenoord
21:00	Sporting CP - Arsenal
21:00	Young Boys - Atalanta

zhvillohet në Milano ku do të përballen Interi dhe Leipzigu. Interi është në vendin e pestë me 10 pikë, kurse klubi gjerman zë vendin e 32-të pa asnjë pikë të grumbulluar.

## Flamuri shqiptar valëvitet në Serbi

LOZNICE, 25 NËNTOR - Tetë medalje në Kampionatin Ballkanik të Boksit që u zhvillua në Loznicë të Serbisë. Dy medalje ari, dy argjendi dhe katër bronz ishte totali i fituar nga boksierët kuqezi, në tri kategori: për të rritur, për të

rinj dhe për juniorë. Padyshim arritja më e rëndësishme ishte ajo e Alban Beqirit, që fitoi medaljen e artë për të rritur, në peshën deri 71 kilogramë. 30-vjeçari ishte totali i fituar nga boksierët kuqezi, në tri kategori: për të rritur, për të

Kubov. Dueli përfundoi në raundin e dytë, me rivalin që nuk arriti ta përballonte furinë e grushteve të Beqirit, i cili i shtoi koleksionit të tij një tjetër medalje ballkanike dhe i dhuroi Shqipërisë një tjetër rezultat të rëndësishëm në arenën ndërkombëtare. Në

ceremoninë përmbyllëse të eventit, Alban Beqiri hipi në shkallën më të lartë të podiumit. Ai bëri që flamuri kuqezi të valëvitej sërish në Serbi, "raporton A2". Arritje e rëndësishme ishte edhe medalja e argjendit e fituar për të rritur nga Kris Bushi, në

peshën deri në 63,5 kilogramë. Mes medaljeve të tjera, Besian Karaj fitoi të artën për të rinj, ndërsa Stiven Xixi mori të bronztën në të njëjtën kategori. Për juniorë, Gashi, Lazri dhe Deliu fituan medalje bronz, ndërsa Jubani mori medaljen e argjendit.

## Futbollistët shqiptarë pushtojnë formacionin e javës në Zvicër

**BASEL, 25 NËNTOR** - Është mbyllur xhiroja e 15-të në Superligën e Zvicrës. Ndeshja kryesore u zhvillua në St Jacob Park në mes të Baselit dhe Servettes. Baseli arriti fitore të madhe 3-1 falë një paraqitje

spetkolare nga ylli Xherdan Shaqiri që realizoi "het-trik". Ndeshje interesante ishte edhe ajo mes Luganos dhe Zurichut, ku fitorja u takoi vendësve me rezultat të thellë 4-1. Portieri kosovar Amir Saipi ishte fantastik në

këtë duel, derisa paraqitje të mirë pati edhe qendërmbrojtësi Alban Hajdari. Ndërkohë golashënues ishte Shkëlqim Vladi. "Sofa Score" ka publikuar formacionin më të mirë të javës së 15-të në

Zvicër, ku përveç Xherdan Shaqirit në të kanë zënë vend edhe Amir Saipi dhe Alban Hajdari. Formacioni: Saipi, Schmitz, Marques, Hajdari, Poaty, Frei, Grgiq, Steffen, Shaqiri, Cognat, Klidje.



## Kroati Josip Ziziq rrëmben trofeun 'Adem Jashari'

**Prishtinë, 25 nëntor** - Boksieri kroat Josip Ziziq në kategorinë +92 është fitues i Turneut të 26 Ndërkombëtar "Adem Jashari". Kroati në duelin final mundi boksierin nga Shqipëria, Gelian Rojku, në një meç mjaft interesant. Të dy boksierët zhvilluan boks cilësor, megjithatë kroati bëri boks më të mirë, goditi më shpesh kundërshtarin duke fituar duelin dhe duke u shpallur fitues i këtij turneu kushtuar komandantit legjendar Adem Jashari. Fituesit të këtij turneu të përmasave ndërkombëtare, trofeun ia dorëzoi presidenti i Federatës së Boksit të Kosovës, Enver Krasniqi. Në këtë turne, i cili zgjati dy dytë dhe që u zhvillua në Pallatin e Rinisë dhe Sporteve në Prishtinë, dominuan boksierët kosovarë. Në nëntë meçet finale, triumfuan gjashtë boksierë të Kombëtares sonë, derisa në dy duelet e fundit dy boksierët kroatë Zvonimir Rebolj dhe



Josip Ziziq ishin më të mirë së dy boksierët nga Shqipëria, Renaldo Bizhga përkatësisht Gelian Rojku. Krahas duelit mes kroatit Ziziq dhe shqiptarit Rojku, duele që zgjuan kërshërinë e të pranishmeve në palestër ishin edhe duelet Bashkim Bojku (Kosovë) - Hysen Karmeshtna (Shqipëri), Shpëtim Bajoku (Kosovë) - Rumen Rumenov (Bullgari), meçe në të cilën fituan vëllezërit Bojku, derisa 'luftë' e fortë është zhvilluar edhe në meçin në mes të Taulant Jakupit (Kosovë) - Ivan Jajqiqit (Kroaci), derisa Patriot Behrami me diskualifikim nga ana e gjyqtarëve mundi Planet Berishë. Në fund organizatorët shpallën më të mirët e këtij

turneu. Josip Ziziq fitoi trofeun "Adem Jashari", tekniku më i mirë Bashkim Bojku, çifti më luftarak Shpëtim Bajoku (Kosovë) - Rumen Rumenov (Bullgari), Kristjan Goco, boksieri më "fer-plej", Orhan Avdi, gjyqtari më i mirë, boksieri më perspektiv Almir Emerllahu (Maqedoni), kurse çmimin boksieri më i mirë vendor e fitoi Taulant Jakupi. Në eventin e 26 me radhë morën pjesë tetë shtete evropiane. Kujtojmë se ky turne është në kalendarin e garave evropiane dhe botërore dhe vlerësohet si një prej ngjarjeve më të mëdha të sportit në Kosovë, marrë parasysh edhe faktin se mbahet nën përkuqdesjen e Kryeministrit

**Boksieri më i mirë: Josip Ziziq**  
**Tekniku më i mirë: Bashkim Bajoku**  
**Qifti më Luftarak: Shpëtim Bajoku - Rumen Rumenov**  
**Boksieri më ferplej: Kristian Koço**  
**Boksieri më perspektiv: Almir Emerllahu**  
**Boksieri më i mirë i huaj: Erik Katona**  
**Boksieri më i mirë vendor: Taulant Jakupi**

## Clevelandi dominon renditjen në NBA, Bostoni 'buzëqesh' në fund

**OHIO, 25 NËNTOR** - Clevelandi vijon të jetë skuadra më e mirë në NBA, duke fituar me rezultat 122-108 ndaj Torontos, sukse si 17 sezonal në 18 takime të luajtura. Mitchell dhe Jerome me nga 26 pikë secili ishin shënuesit më të mirë të Cavaliersit në këtë sfidë. Fitoi edhe skuadra kampione e Bostonit, që mban vendin e dytë në Lindje. Celticsi mposhti me rezultat 107-105 Minnesotan në sekondat e fundit, në një ndeshje me rivalitet. Brown me



29 pikë e Tatum me 26 bënë dallimin në fushë. Pas kohës shtesë triumfoi Miami, që mundi me rezultat 123-118 Dallasin, sfidë ku u dallua

Jimmy Butler me 33 pikë. Jashtë fushës fitoi ekipi i clippersave, që mundi me rezultat 125-99 Philadelphian, ndeshje ku shkëlqeu James Hardeni me 23 pikë.

### REZULTATET

Boston - Minnesota	107-105
Indiana - Washington	115-103
Miami - Dallas	123-118
Philadelphia - Clippers	99-125
Cleveland - Toronto	122-108
Sacramento - Brooklyn	103-108

## Nagelsmanni: Do të jenë dy ndeshje spektakolare

Julian Nagelsmann po e pret me padurim sfidën me Italinë. Trajneri i Gjermanisë i ka thurur elozhe rivalit dhe thotë se po kalon një moment shumë pozitiv. "Po e pres me

padurim momentin për të luajtur. Italia është një rivale e madhe dhe ashtu si ne ka rigjetur forcën e dikurshme. Bën futboll ofensiv dhe agresiv. Në këtë moment do të luajmë

ndaj rivales që është më e qëndrueshme dhe në formë optimale", ka thënë Nagelsmanni. Më tej, trajneri gjerman foli edhe për rivalin e ardhshëm. "Është diçka

pozitive për rritjen tonë sepse do të luajmë ndaj skuadrave më të mira të Evropës për momentin. Nëse shkojmë në gjysmëfinale, do të jetë një ndeshje emocionuese edhe

kundër Danimarkës ose Portugalisë. Por fillimisht duhet që ta bëjmë detyrën tonë përballë Italisë. Do të jenë sfida të bukura", përfundoi trajneri i kombëtares së Gjermanisë.

### SHKURT

#### Verstappeni: Nuk e kisha besuar kurrë se do të arrija një gjë të tillë

"Nuk e kisha besuar kurrë se një gjë e tillë do të ishte e mundur për mua". Është ky koment i parë që Max Verstappeni tha pas fitimit të titullit të katërt kampion bote për pilotë në Formula 1. Piloti holandez i Red Bullit u klasifikua i pesti sot në garën e zhvilluar në Las Vegas, por kaq mjaftoi që ai ta sigurojë matematikisht titullin kampion për pilotë. Ai la pas rivalin e tij për titull, Lando Norris. "Çfarë sezoni. Katër herë kampion bote. Falënderoj të gjithë skuadrën time. Të gjithë! Këtë vit ishte paksa më e vështirë se vitin e kaluar, por ne i kaluam të gjitha vështirësitë", ka thënë më tej Verstappeni. "Ishte një sezon i gjatë, me shumë sfida dhe m'u desh të luftoja shumë. Gjithsesi, si unë ashtu edhe skuadra ime jemi krenarë, pasi kemi besuar dhe ia dolëm mbanë", ka deklaruar Verstappeni që mori titullin e katërt radhazi.

#### Italia mund Holandën në finale dhe fiton për herë të dytë radhazi 'Kupën Davis'

Italia fitoi për të tretën herë në historinë e saj Kupën Davis për meshkuj në tenis, duke mbrojtur titullin fituar një vit më parë. Në finalen e luajtur në Spanjë, kombëtarja "azzurre" mundi 2-0 Holandën. Në ndeshjen e parë, tenisti Matteo Berrettini fitoi 2-0 (6-4, 6-2) ndaj Botic Van de Zandschulp, ndërsa në sfidën e dytë ishte Jannik Sinner ai që triumfoi po 2-0 (7-6, 6-2) ndaj Tallon Griekspoor. Për pasojë nuk ishte e nevojshme zhvillimi i lojës dyshe. Ky sukses i djemve vjen një javë pas atij të femrave, ku tenistet italiane fituan trofeun e "Billie Jean King". Një moment i mirë ky për tenisitalian.

#### Guardiola pas humbjes nga 'Spurs': Do të rikthehem

Manchester City pësoi humbjen e pestë radhazi, një humbje e thellë 0-4 brenda në "Etihad" nga Tottenham Hotspur. Trajneri Pep Guardiola ka thënë se në tetë vitet e fundit City nuk ka përjetuar një situatë të tillë, po ka premtuar se do të rikthehet edhe më i fortë. "Në tetë vjet nuk kemi përjetuar kurrë një situatë të tillë. Tani nuk na mbetet gjë tjetër vetëm ta përjetojmë këtë moment dhe ta kalojmë duke fituar ndeshjen e radhës. Do të rikthehem, do të bëjmë këtë, të jeni të sigurt", ka thënë Guardiola.

#### Reali konfirmon lëndimin e Viniciusit

Real Madridi përmes një komunikate në rrjetet sociale ka njoftuar për lëndimin që ka pësuar ylli i skuadrës Vinicius Junior. Futbollisti brazilian u paraqit për 90 minuta në ndeshjen ndaj Leganesit aty ku pati një paraqitje tejet të mirë dhe dhuroi një asistim. Fakti se ai luajti deri në përfundim të takimit nuk bëri që të vërehet se ka shqetësime për shkak të një lëndimi të mundshëm. "Pas testeve të bëra sot te lojtari ynë Vini Jr nga stafi mjekësor i Real Madridit, ai është diagnostifikuar me një lëndim muskolor në këmbën e majtë", ka njoftuar klubi spanjoll. Sipas raportimeve të fundit nga mediet spanjolle, Vinicius pritet të mungojë rreth tri javë duke humbur kështu sfidën ndaj Liverpoolit në mesjavë në kuadër të Ligës së Kampionëve. Qëllimi kryesor i reprezentuesit brazilian tashmë është që të rikthehet për finalen në garën "Intercontinental Cup" që do të zhvillohet më 18 dhjetor.



### SHPALLJE E VENDIT TË LIRË TË PUNËS

<b>Pozita:</b>	Administrator/e i/e Rrjetit (zyrtar i ri)
<b>Departamenti:</b>	Teknologjia Informative
<b>Divizioni:</b>	Teknologjisë Informative dhe Sistemeve
<b>Grada:</b>	7
<b>Raporton tek:</b>	Udhëheqësi i Divizionit të Teknologjisë Informative dhe Sistemeve

Administratori i Rrjetit është përgjegjës për administrimin, përmirësimin dhe avancimin e infrastrukturës së rrjetave të teknologjisë informative. Gjithashtu është përgjegjës për sigurinë e informacionit në infrastrukturën e rrjetit.

#### Përgjegjësitë dhe detyrat e punës:

- Instalon, konfigurim, administron dhe mirëmban të gjitha komponentët e rrjetave (Router, Firewall, Switch) që janë pjesë e infrastrukturës së TI-së në BQK.
- Konfigurim dhe mirëmban ndërlidhjet (VPN) me institucionet tjera.
- Analizon kërkesat për ndryshim ose shtim të funksioneve në rrjetin e BQK-së dhe ofron zgjidhje adekuate.
- Bashkëpunon ngusht me administratorët dhe teknikët brenda divizionit dhe me zyrtarët e divizioneve tjera.
- Trajton gjetjet nga monitorimet dhe raportet e sigurisë së informacionit.
- Shërben si nivel i dytë i trajtimit të incidenteve dhe problemeve tek të gjithë shfrytëzuesit e teknologjisë informative.
- Zgjidh problemet që raportohen nga shfrytëzuesit e brendshëm dhe të jashtëm të rrjetit të BQK.
- Monitoron dhe bën matje të performancës së komponentëve të rrjetave, duke përfshirë pajisjet e BQK-së në shfrytëzim nga shfrytëzuesit e jashtëm.
- Mirëmban licencat dhe komunikon me ofruesit e shërbimeve të jashtme.
- Planifikon dhe ofron zgjidhje bazuar në matjet e komponentëve për të siguruar vazhdimësinë dhe sigurinë e shërbimeve të rrjetit.
- Mirëmban dokumentim të konfigurimeve, krijon procedura dhe manuale për të gjitha pajisjet dhe shërbimet për të cilat është përgjegjës.
- Merr pjesë aktive në përgatitjet dhe planifikimet afatshkurta dhe afatgjata të TI-së.
- Aplikon udhëzimet dhe standardet e sigurisë.
- Detyra tjera që i caktohen nga përgjegjësit në hierarkinë e Departamentit të Teknologjisë Informative dhe Sigurisë

#### Kualifikimet dhe përvoja:

- Shkallë bachelor në shkencë kompjuterike ose certifikime përkatëse që lidhen me rolin e administratorit të rrjetit.
- Përvojë e preferuar, së paku 1 vjeçare në administrim të rrjetave.
- Përvoja në ambiente komplekse të infrastrukturës së TI, e preferuar.
- Njohuri në menaxhim të firewall-ëve
- Gjuha angleze e preferuar.

#### Të gjithë kandidatët duhet të dërgojnë dokumentet e mëposhtme:

- Formularin zyrtar të BQK-së për aplikim;
- Letrën përcjellëse (motivuese) ku theksohet interesimi dhe përshtatshmëria për këtë pozitë;
- Kopjet e diplomave, ndërsa diplomat e fituara jashtë Republikës së Kosovës duhet të jenë të njohura /nostrifikuara zyrtarisht nga ana e MASHT-it;
- Kopjen e certifikatës profesionale;
- Dëshmi mbi identitetin/kopja e letërnjoftimit që shërben për të vërtetuar shtetësinë e Kosovës.

#### Procedura e aplikimit:

- Afati i fundit për aplikim është **11 dhjetor 2024**.
- Aplikimi mund të bëhet online (<https://hris.bqk-kos.org>) përmes faqes zyrtare të BQK-së ose përmes arkivit të BQK-së. Format tjera të aplikimit nuk do të merren parasysh.
- Formën e aplikacionit mund ta shkarkoni përmes faqes zyrtare: [www.bqk-kos.org](http://www.bqk-kos.org)



### OGLAS ZA SLOBODNO RADNO MESTO

<b>Naziv radnog mesta:</b>	Administrator/ka mreže (novi službenik)
<b>Odeljenje:</b>	Informacione tehnologije
<b>Odsek:</b>	Informacione tehnologije i sistemi
<b>Stepen:</b>	Sedam (7)
<b>Izveštava:</b>	Šefu Odeljenja za informacione tehnologije i sisteme

Administrator/ka mreže je odgovoran/na za administraciju, poboljšanje i unapređenje infrastrukture mreže informacionih tehnologija. Takođe je odgovoran/na za bezbednost informacija u infrastrukturi mreže.

#### Radne dužnosti i odgovornosti:

- Instalira, konfigurise, administrira i održava sve komponente mreže (Router, Firewall, Switch) koje su deo IT infrastrukture u CBK-u.
- Konfigurise i održava interkonekcije (VPN) sa drugim institucijama.
- Analizira zahteve za promenu ili dodavanje funkcija u mreži CBK-a i nudi adekvatna rešenja.
- Blisko saraduje sa administratorima i tehničarima unutar odseka kao i sa službenicima iz drugih odseka.
- Obraduje nalaze praćenja i izveštaja o bezbednosti informacija.
- Služi kao drugi nivo rešavanja incidenata i problema za sve korisnike informacionih tehnologija.
- Rešava probleme prijavljeni od strane internih i eksternih korisnika mreže CBK-a.
- Prati i meri učinak komponentata mreže, uključujući opremu CBK koju koriste spoljni korisnici.
- Održava licence i komunicira sa eksternim pružiocima usluga.
- Planira i daje rešenja zasnovana na merenja komponenti kako bi se osigurao kontinuitet i bezbednost mrežnih usluga.
- Održava dokumentaciju vezano za konfiguraciju, kreira postupke i priručnike za celu opremu i usluge za koje je odgovoran.
- Aktivno učestvuje u kratkoročnim i dugoročnim IT pripremanjima i planiranju.
- Primenjuje uputstva i standarde bezbednosti.
- Ostale zadatke koji se određuju od strane odgovornih osoba po hijerarhiji Odeljenja za informacione tehnologije.

#### Kvalifikacije i iskustvo:

- Diploma iz bachelor studija u računarskim naukama ili odgovarajući sertifikati relevantni za ulogu administratora mreže.
- Poželjno iskustvo, najmanje 1 godina u administraciji mreže.
- Poželjno iskustvo u složenim okruženjima IT infrastrukture.
- Poznavanje upravljanja firewall-a
- Engleski jezik, poželjno.

#### Svi kandidati moraju poslati sledeća dokumenta:

- Službeni obrazac CBK-a za prijavu;
- Propratno (motivaciono) pismo u kojem je naglašen interes i prikladnost za ovaj položaj;
- Kopije diploma, a diplome stečene van Republike Kosovo moraju biti zvanično priznate/ nostrifikovane od strane MONT-a;
- Kopiju stručnog sertifikata;
- Dokaz o identitetu/kopija lične karte koja služi za dokazivanje državljanstva Kosova.

#### Postupak prijave:

- Rok za prijavu je **11 decembar 2024. godine**.
- Prijava se može vršiti i putem interneta (<https://hris.bqk-kos.org>) preko zvanične internet stranice CBK-a ili preko arhive CBK-a. Ostali obrasci za prijavu neće se razmatrati.
- Obrazac za prijavu možete preuzeti preko službene internet stranice: [www.bqk-kos.org](http://www.bqk-kos.org)



## Përshkrimi i pozitës

<b>Titulli:</b>	<b>Analist i sigurisë kibernetike</b> (Zyrtar i ri)
<b>Departamenti/ Divizioni:</b>	Teknologjia Informative dhe Sigurisë / Divizioni i Sigurisë Kibernetike dhe Vazhdimësisë
<b>Niveli i gradës:</b>	7
<b>I raporton:</b>	Udhëheqësit të Divizionit të Sigurisë Kibernetike dhe Vazhdimësisë

### Numri i vartësve, nëse ka: Nuk ka

### Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Konfiguroni sistemet dhe veglat e sigurisë së informacionit, i mirëmban dhe sigurohet që të funksionojnë sipas kërkesave, duke përfshirë sistemet për mbledhje të log-ëve, skanime të sigurisë për dobësi dhe sistemet e tjera të sigurisë së informacionit.
- Monitoron rrjetin kompjuterik për çështjet e sigurisë.
- Monitoron, analizon dhe raporton alarmet e sigurisë, incidentet, raportet mbi dobësitë që mblidhen nga disa burime, si: SIEM, sisteme të tjera të monitorimit, skanime të dobësive, etj.
- Rishikon, hulumton dhe raporton alarmet e dobësive, duke ofruar:
  - analizën relevante të tyre,
  - propozon përmirësimet e nevojshme dhe përcjellë përmirësimet e propozuara,
  - menaxhon skanimet e planifikuara, identifikon zbrazëtitë në to dhe zgjeron fushën e skanimeve sipas nevojës, si dhe përshkallëzon alarmet e sigurisë sipas nevojës.
- Hulumton shkeljet e sigurisë dhe incidentet tjera të sigurisë kibernetike.
- Dokumenton shkeljet e sigurisë dhe vlerëson dëmin që ato shkaktojnë.
- Punon me ekipin e sigurisë për të kryer teste dhe për të zbuluar dobësitë e rrjetit.
- Rregullon dobësitë e zbuluara për të ruajtur një standard të lartë të sigurisë.
- Zhvillon praktikatat më të mira për sigurinë e informacionit.
- Ndihmon në përgatitjen dhe implementimin e programit të vetëdijesimit të shfrytëzuesve të BQK-së.
- Mbështet iniciativat e propozuara të sigurisë së informacionit që të siguroj suksesin e tyre.
- Qëndron i azhurnuar në lidhje me avancimet në fushën e teknologjisë së informacionit dhe standardet e sigurisë.
- Kryen detyra të tjera sipas kërkesës së udhëheqësit

### Edukimi:

Shkallë universitare (bachelor) nga një institucion i akredituar në Kosovë në fushën e Shkencave Kompjuterike ose certifikime relevante në fushën e sigurisë së informacionit (p.sh. CEH, CCNA Security, Microsoft MTA Security, CompTia Security+, CompTIA CySA+ dhe certifikime tjera ndërkombëtare të fushës së sigurisë së informacionit). Ata të cilët kanë përfunduar shkollim jashtë vendit duhet të ofrojnë nostrifikimin e diplomës nga MASHT).

### Përvoja e punës:

Preferohet të paktën 1 vit përvojë në fushë e sigurisë së informacionit.

### Njohja e gjuhëve të huaja:

Gjuha angleze e preferuar.

### Të gjithë kandidatët duhet të dërgojnë dokumentet e mëposhtme:

- Formularin zyrtar të BQK-së për aplikim;
- Letrën përcjellëse (motivuese) ku theksohet interesimi dhe përshtatshmëria për këtë pozitë;
- Kopjet e diplomave, ndërsa diplomat e fituara jashtë Republikës së Kosovës duhet të jenë të njohura /nostrifikuara zyrtarisht nga ana e MASHT-it;
- Kopjen e certifikatës profesionale;
- Dëshmi mbi identitetin/kopja e letërnjoftimit që shërben për të vërtetuar shtetësinë e Kosovës.

### Procedura e aplikimit:

- Afati i fundit për aplikim është **11 dhjetor 2024**.
- Aplikimi mund të bëhet online (<https://hris.bqk-kos.org>) përmes faqes zyrtare të BQK-së ose përmes arkivit të BQK-së. Format tjera të aplikimit nuk do të merren parasysh.
- Formën e aplikacionit mund ta shkarkoni përmes faqes zyrtare : [www.bqk-kos.org](http://www.bqk-kos.org)



## Opis pozicije

<b>Naziv:</b>	<b>Analitičar kibernetičke bezbednosti</b> (novi službenik)
<b>Odeljenje/ Odsek:</b>	Informaciona tehnologija i bezbednost/ Odsek za kibernetičku bezbednost i kontinuitet
<b>Nivo stepena:</b>	7
<b>Izveštava:</b>	šefu Odseka za kibernetičku bezbednost i kontinuitet

**Broj podređenih, ako ih ima:** Nema

### Dužnosti i odgovornosti:

- Konfigurise sisteme i alate za bezbednost informacija, održava i obezbeđuje da funkcionišu prema zahtevima, uključujući sisteme za prikupljanje logova, skeniranje bezbednosti za slabosti i druge sisteme za bezbednost informacija.
- Prati mrežu računara za bezbednosna pitanja.
- Prati, analizira i prijavljuje bezbednosna upozorenja, incidente, izveštaje o slabostima koji se prikupljaju iz više izvora, kao što su: SIEM, drugi sistemi za praćenje, skeniranje slabosti itd.
- Pregleda, istražuje i prijavljuje upozorenja o ranjivosti, pružajući:
  - njihovu relevantnu analizu,
  - predlaže potrebna poboljšanja i prati predložena poboljšanja,
  - upravlja planiranim skeniranjima, identifikuje nedostatke u njima i proširuje oblast skeniranja po potrebi kao i eskalira bezbednosna upozorenja po potrebi.
- Istražuje kršenja bezbednosti i druge incidente kibernetičke bezbednosti.
- Dokumentuje kršenja bezbednosti i procenjuje štetu koju oni uzrokuju.
- Radi sa bezbednosnim timom na izvođenju testova i otkrivanju slabosti mreže.
- Popravlja otkrivene slabosti kako bi se održao visok standard bezbednosti.
- Razvija najbolje prakse za bezbednost informacija.
- Pomaže u pripremi i sprovođenju programa za podizanje svesti korisnika CBK-a.
- Podržava predložene inicijative za bezbednost informacija kako bi se osigurao njihov uspeh.
- Ostaje ažuriran u vezi sa napredima u informacionoj tehnologiji i bezbednosnim standardima.
- Obavlja i druge poslove po zahtevu šefa.

### Obrazovanje:

Univerzitetski stepen (bačelor) iz akreditovane institucije na Kosovu u oblasti računarskih nauka ili relevantne sertifikate u oblasti informacione bezbednosti (npr. CEH, CCNA Security, Microsoft MTA Security, CompTia Security+, CompTIA CySA + i drugi međunarodni sertifikati iz oblasti informacione bezbednosti). Oni koji su završili školovanje u inostranstvu moraju da obezbede nostrifikaciju svoje diplome od strane MONT-a).

### Radno iskustvo:

Poželjno je najmanje 1 godina iskustva u oblasti informacione bezbednosti.

### Poznavanje stranih jezika:

Engleski jezik, poželjno.

### Svi kandidati moraju poslati sledeća dokumenta:

- Službeni obrazac CBK-a za prijavu;
- Propratno (motivaciono) pismo u kojem je naglašen interes i prikladnost za ovaj položaj;
- Kopije diploma, a diplome stečene van Republike Kosovo moraju biti zvanično priznate/ nostrifikovane od strane MONT-a;
- Kopiju stručnog sertifikata;
- Dokaz o identitetu/kopija lične karte koja služi za dokazivanje državljanstva Kosova.

### Postupak prijave:

- Rok za prijavu je **11 decembar 2024. godine**.
- Prijava se može vršiti i putem interneta (<https://hris.bqk-kos.org>) preko zvanične internet stranice CBK-a ili preko arhive CBK-a. Ostali obrasci za prijavu neće se razmatrati.
- Obrazac za prijavu možete preuzeti preko službene internet stranice: [www.bqk-kos.org](http://www.bqk-kos.org)



### Përshkrimi i pozitës

**Titulli:** Zhvillues i Softuerit (Zyrtar i Ri)

**Departamenti/ Divizioni:** Teknologjisë Informative dhe Sigurisë/Divizioni i Zhvillimit

**Niveli i gradës:** 7

**I raporton:** Udhëheqësit të Divizionit të Zhvillimit

**Numri i vartësve, nëse ka:**

**Detyrat dhe përgjegjësitë:**

Zhvilluesi i softuerit merret me të gjitha fazat e zhvillimit të softuerit, duke filluar nga analiza e kërkesave, dizajnimi i softuerit, implementimi, dokumentimi e deri te testimi i softuerit. Gjithashtu, kontribuon në përmirësimin e softuerëve ekzistues, gjetjen e gabimeve dhe korrigjimin e tyre.

- Merret me zhvillimin aplikacioneve softuerike;
- Dizajnon dhe krijon bazat e të dhënave për aplikacionet që zhvillohen;
- Dizajnon raporte sipas kërkesave;
- Bën automatizimin e testimi të aplikacioneve;
- Bën analizë të kodit (ang. Code review) të shkruar nga anëtarët e tjerë të ekipit;
- Identifikon gabimet në softuer dhe bën korrigjimin e tyre;
- Merr pjesë aktive në pranimin, analizimin dhe vlerësimin e kërkesave (ang. requirements) për zhvillimin e aplikacioneve të reja apo shtimin e funksionaliteteve në ato ekzistuese, si dhe bën korrigjimin e gabimeve (të identifikuar nga shfrytëzuesit);
- Mirëmban aplikacionet që zhvillohen dhe ato ekzistuese;
- Shkruan dokumentacion teknik të softuerit;
- Shkruan dokumentin udhëzues për përdorim të softuerit;
- Kryen edhe detyra të tjera të caktuara nga udhëheqësi.

**Edukimi:**

- Shkallë universitare (baçelor) në fushën e shkencave kompjuterike, elektroteknike apo të matematikës ose certifikime në fushën përkatëse;

**Përvoja e punës:**

- Preferohet të paktën 1 vit përvojë në zhvillim të softuerit;
- Preferohet përvojë në Angular dhe .NET

**Njohja e gjuhëve të huaja:**

- Gjuha angleze, e preferuar

**Të gjithë kandidatët duhet të dërgojnë dokumentet e mëposhtme:**

- Formularin zyrtar të BQK-së për aplikim;
- Letrën përcjellëse (motivuese) ku theksohet interesimi dhe përshtatshmëria për këtë pozitë;
- Kopjet e diplomave, ndërsa diplomat e fituara jashtë Republikës së Kosovës duhet të jenë të njohura /nistrifikuara zyrtarisht nga ana e MASHT-it;
- Kopjen e certifikatës profesionale;
- Dëshmi mbi identitetin/kopja e letërnjoftimit që shërben për të vërtetuar shtetësinë e Kosovës.

**Procedura e aplikimit:**

- Afati i fundit për aplikim është **11 dhjetor 2024**.
- Aplikimi mund të bëhet online (<https://hris.bqk-kos.org>) përmes faqes zyrtare të BQK-së ose përmes arkivit të BQK-së. Format tjera të aplikimit nuk do të merren parasysh.
- Formën e aplikacionit mund ta shkarkoni përmes faqes zyrtare : [www.bqk-kos.org](http://www.bqk-kos.org)



### Opis pozicije

**Naziv:** Programer softvera (novi službenik)

**Odeljenje/odsek:** Informacione tehnologije i bezbednost/ Odsek razvoja

**Nivo stepena:** 7

**Izveštava:** šefu Odseka razvoja

**Broj podređenih, ako ih ima:**

**Dužnosti i odgovornosti:**

Programer softvera se bavi svim fazama za razvoj softvera, počev od analize zahteva, dizajna softvera, implementacije, dokumentiranja sve do testiranja softvera. Takođe, doprinosi poboljšanju postojećih softvera, pronalaženju grešaka i njihovom ispravljanju.

- Bavi se razvojem softverskih aplikacija;
- Dizajnira i kreira baze podataka za aplikacije koje se razvijaju;
- Dizajnira izveštaje prema zahtevima;
- Vršiti automatizaciju testiranja aplikacija;
- Vršiti analizu koda (eng. Code review) napisan od strane drugih članova tima;
- Identifikuje softverske greške i ispravlja ih;
- Aktivno učestvuje u prijemu, analizi i proceni zahteva (eng. requirements) za razvoj novih aplikacija ili dodavanju funkcionalnosti na one postojeće, kao i vrši ispravku grešaka (koje su identifikovali korisnici);
- Održava aplikacije, one postojeće i one koje se razvijaju;
- Piše tehničku dokumentaciju softvera;
- Piše dokument za uputstvo za korišćenje softvera;
- Obavlja i druge poslove koje mu odredi šef.

**Obrazovanje:**

- Univerzitetski stepen (bačelor) iz oblasti kompjuterske, elektrotehničke ili matematičke oblasti ili sertifikati iz odgovarajuće oblasti;

**Radno iskustvo:**

- Poželjno je najmanje 1 godina iskustva u razvoju softvera;
- Poželjno je iskustvo u Angularu i .NET-u

**Poznavanje stranih jezika:**

- Engleski jezik, poželjno.

**Svi kandidati moraju poslati sledeća dokumenta:**

- Službeni obrazac CBK-a za prijavu;
- Propratno (motivaciono) pismo u kojem je naglašen interes i prikladnost za ovaj položaj;
- Kopije diploma, a diplome stečene van Republike Kosovo moraju biti zvanično priznate/ nostrifikovane od strane MONT-a;
- Kopiju stručnog sertifikata;
- Dokaz o identitetu/kopija lične karte koja služi za dokazivanje državljanstva Kosova.

**Postupak prijave:**

- Rok za prijavu je **11 decembar 2024. godine**.
- Prijava se može vršiti i putem interneta (<https://hris.bqk-kos.org>) preko zvanične internet stranice CBK-a ili preko arhive CBK-a. Ostali obrasci za prijavu se neće razmatrati.
- Obrazac za prijavu možete preuzeti preko službene internet stranice: [www.bqk-kos.org](http://www.bqk-kos.org)





## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulo C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales





**MEKA**  
HALAL FOOD

# TRADITË QË NGA

# 1992

